



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 3246 prot.

Tiranë, më 12.01.2021

Lënda: Njoftim

SHOQËRISË "VI - ES" SH.P.K.

**Adresa: Rruga "Arkitekt Sinani",
nr. 19, Tiranë.**

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së dërguar nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me shkresën nr. 1365/5 prot., datë 04.11.2020, ka vendosur përjashtimin e operatorit "VI-ES" nga pjesëmarrja në prokurimet publike, në mbështetje të nenit 13/3/ç të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Me shkresën Nr. 7132 Prot., datë 30.12.2020, APP ju ka dërguar një kopje të Vendimi Nr. 80 Prot., datë 30.12.2020, në adresën e dhënë sipas Ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Kjo shkresë nuk ka shkuar në destinacion dhe është kthyer mbrapsht nga Posta Shqiptare, me justifikimin adresa juaj ka ndryshuar. APP, ka rinisur shkresën e sipërcituar drejtuar operatorit tuaj ekonomik në datë 07.01.2021, e cila është kthyer përsëri nga shërbimi postar.

Sa më sipër, nëpërmjet këtij njoftimi publik, APP njofton shoqërinë tuaj që të paraqitet pranë APP për tërheqjen e kopjes së vendimit të sipërcituar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

